


# Si t'i mbështesni fëmijët tuaj interseks



Përgatitur nga IGLYO, Oii Europe & EPA  
Përshtatur dhe botuar në shqip nga TLAS





# Përmbajtja

Çfarë do të thotë të jesh interseks?	2
Këshilla për prindërit	4
Pyetje dhe përgjigje	6
Marrja e vendimeve rreth ndërhyrjeve kirurgjike	14
Si t'i flasim fëmijës rreth interseksualizmit	18
Si t'i themi të tjerëve që fëmija im është interseks	22
Pyetje që të tjerët ngrenë rreth personave interseks	24

## Shkurtime

TLAS, (Shërbimi Ligjor Falas Tiranë)

MSHMS

IGLYO, (Organizata Nderkombëtare e të rinjëve LGBTI)

OII Europe, (Organizata Nderkombëtare Intersex ne Europë)

EPA, (Shoqata Europiane e Prindërve)


# Hyrje

Çfarë do të thotë Interseks?

A është vajzë apo djalë? Kjo është pyetja që dëgjohet zakonisht pas lindjes së një fëmije. Shumë prindër mund t'i japin përgjigje lehtësisht kësaj pyetjeje. Por për një numër prindërish kjo pyetje mund të jetë e vështirë për t'i dhënë përgjigje.

Termi interseks i referohet karakteristikave seksuale atipike të brendshme dhe/ose të jashtme anatomike, ku tiparet seksuale që konsiderohen si mashkullore apo femërore mund të shfaqen njëkohësisht dhe të ndërthuren me njëra tjetrën deri në një farë mase. Kjo dukuri tek një numër personash të porsalindur duhet të konsiderohet si ndryshim i natyrshëm dhe jo si gjendje mjekësore.

Për disa persona interseks, interseksualizmi shfaqet dhe është i dukshëm që në lindje, për disa shfaqet gjatë fëmijërisë, dhe për të tjerë këto karakteristika dalin në pah gjatë adoleshencës ose/dhe gjatë moshës madhore. Por ka edhe persona interseks që mund të mos e kuptojnë kurrë që janë interseks, për shkak se tiparet atipike seksuale janë minimale.



Ka shumë mënyra se si këto variacione të karakteristikave seksuale mund të kombinohen. Një fëmijë mund të lindë me një klitor më të gjatë ose me një penis me formë të ndryshme nga ajo çfarë mund të cilësohet lehtësisht i seksit mashkull. Një tjetër mund të lindë me pamje femërore, por zbulohet se mbart testikuj të brendshëm, ose anasjelltas, fëmija ka pamje të jashtme mashkullore dhe mbart vezore. Ka raste që një vajzë nuk i vijnë menstruacionet dhe një djali mund t'i fillojnë ato. Po ashtu ndodh që disa fëmijë interseks kanë bagazh hormonal të ndryshëm nga ata që janë qartësisht mashkull ose femër.

Këto variacione konsiderohen të natyrshme dhe mund të jenë më të përhapura nga sa e mendojmë. Është përlogaritur se në shkallë botërore së paku 1 në 2000 persona lindin interseks, ose rreth 1.7% e popullsisë botërore kanë variacione në karakteristikat apo tiparet seksuale.

*Karakteristikat seksuale ndahen në dy kategori: Primare dhe sekondare*

*Karakteristikat seksuale primare janë ato që shfaqen në lindje. Këtu përfshihen kromozomet, organet gjenitale, sistemi riprodhues dhe sistemi hormonal*

*Karakteristikat seksuale sekondare janë tiparet seksuale që bëhen të dukshme gjatë procesit të rritjes ose pubertetit dhe përfshijnë zhvillimin e gjoksit, rritjen e qimeve, menstruacionet, "mollën" e Adamit, muskujt dhe zgjerimin e vitheve.*

Ky manual është hartuar nga organizatat ndërkombëtare: IGLYO, (Organizata Nderkombëtare e të rinjve LGBTI).

Oll Europe, (Organizata Ndërkombëtare Interseks ne Europë) dhe EPA (Shoqata Europiane e Prindërve). Manuali ka për qëllim prezantimin e temës, dhënien e këshillave për prindërit e fëmijëve interseks dhe se si duhet t'i mbështesim më mirë këta persona.

TLAS (Shërbimi Ligjor Falas Tiranë) ka përshtatur dhe botuar këtë material në gjuhën shqipe.

# Këshilla për Prindërit

Momenti kur prindërit mësojnë se fëmija i tyre është interseks pa dyshim përbën një “surprizë” të madhe për ta. Shumica e tyre ndihet e papërgatitur për të rritur një fëmijë interseks për shkak të mungesës së theksuar të informacionit.

Nga intervistat e realizuara me prindër të fëmijëve interseks, rezulton se kryesisht ata ndihen shumë të shqetësuar për mirëqënien e fëmijës. Një pjesë e prindërve pohon se jo rrallë herë vetë mjekët pohojnë që fëmija interseks nuk është një fëmijë i shëndetshëm.

Duhet theksuar se një fëmijë interseks është si çdo fëmijë tjetër që kërkon kujdesin, dashurinë dhe përkushtimin prindëror, që do të gëzojë, do të qeshë dhe qajë, do t’ju bëjë të lumtuar dhe nervozojë ashtu si gjithë të tjerët. Së dyti, edhe këta fëmijë kur të rriten do të jenë të aftë dhe të gatshëm të marrin vendime për edukimin apo drejtimin e jetës së tyre. Fëmijët interseks janë thjesht një provë që tregon se sa e ndryshme është natyra njerëzore.

Ky Manual jep disa këshilla bazë dhe orientuese drejtuar prindërve në mënyrë që ata t’i japin mbështetjen e duhur fëmijës interseks, siç do të bënin për çdo fëmijë tjetër.

## **Nuk ka asgjë të gabuar me fëmijën tuaj**

Për shumicën e personave interseks, nuk ka asgjë të gabuar në fizikun e tyre dhe nuk është aspak e nevojshme ndërhyrja kirurgjikale. Në rastet kur mjeku thotë se trajtimi mjekësor është i nevojshëm, mos ngurroni të pyesni rreth komplikacioneve të mundshme në shëndetin e fëmijës dhe rrezikut që mund të vijë si pasojë e ndërhyrjes ose e mos ndërhyrjes. Çdo vendim duhet të merret mbasi të jeni të mirëinformuar. Pyesni dhe konsultohuni me sa më shumë mjekë profesionistë dhe bëni kërkime.

## **Nuk është faji juaj**

Kur prindërit marrin vesh se fëmija i tyre ka lindur interseks, menjëherë fillojnë dhe pyesin vehten "Ku kemi gabuar?", "A mund ta kishim parandaluar këtë gjë?". Përgjigja është: Nuk keni bërë asnjë gabim, nuk keni faj dhe nuk ka asgjë për t'u turpëruar. Të lindurit interseks është diçka e natyrshme dhe jo anomali.

## **Është normale të ndiheni konfuz ose të mërzitur**

Kur jeni duke pritur një fëmijë, është normale të keni pretendimin tuaj dhe sigurisht do t'ju gjejë shumë të papërgatitur lajmi i papritur kur mësoni se fëmija juaj ka gjini të papërcaktuar. Kur zbulon se fëmija është interseks, do të ndiheni të frikësuar, të mërzitur, ankthioz, të shqetësuar, etj. Këto ndjesi rrjedhin si pasojë e mungesës së informacionit. E rëndësishme është të kontaktoni specialistët e duhur për t'u informuar më shumë. Përmes bisedave me mjekë profesionistë neonatologë e endokrinologë, me psikologë, miq e familjarë, me organizata të specializuara që janë ndeshur me raste të ngjashme, dhe është e sigurtë që do të gjeni informacionin e mbështetjen e duhur.

## **Nuk jeni të vetmit**

Mund të mendoni se jeni të vetmit që po e kaloni një eksperiencë të tillë dhe ju duket situata e pashpresë, sikur askush nuk mundet t'ju kuptojë. E vërteta është se ka një numër organizatash të fokusuara në çështjet interseks që mund t'ju ofrojnë informacion, këshillim dhe mbështetje. Një metodë e mirë është dhe të komunikuarit me prindër të tjerë të fëmijëve interseks. Mos e mbani sekret faktin që jeni prind i një fëmije interseks, pasi kjo gjë nuk ju dëmton vetëm juve psikologjikisht por edhe fëmijën tuaj. Nëse ndiheni të rrezikuar dhe jo gati për të folur hapur për fëmijën tuaj, atëherë vihuni në kontakt me Shërbimin Ligjor Falas Tiranë (TLAS)<sup>1</sup>, organizatë e cila mund t'ju ndihmojë të gjeni këshillën dhe rekomandimin e duhur si dhe të kontaktoni prindër të tjerë që ndodhen në të njëjtën situatë me ju.

## **Mos u nxitoni dhe informohuni gradualisht për interseksualizmin**

Me kalimin e kohës, tekta do t'i flisni fëmijës si dhe të tjerëve, një mori pyetjesh do të lindin. Kjo mund të sjellë ngarkesë psikologjike si dhe do t'ju duket sikur duhet të jeni një ekspert për të trajtuar fëmijën tuaj. Në të njëjtën kohë nuk duhet të ndiheni të turpëruar. Sa më shumë të lexoni apo të diskutoni me të tjerët, aq më mirë do të ndiheni dhe do ti jepni një mbështetje më të mirë fëmijës suaj.

<sup>1</sup>Adresa: Bulevardi "Bajram Curri", p. "Agimi", shk. 18, ap.322, Tiranë, Shqipëri.  
Tel/Fax: +355 04 258442; Mob; 0692093731; P.O. Box. 69; Email: [tlas@tlas.org.al](mailto:tlas@tlas.org.al); web: [www.tlas.org.al](http://www.tlas.org.al)

# Pyetje dhe përgjigje

## Si ta kuptoj që fëmija im është interseks?

Ju mund ta kuptoni që fëmija është lindur interseks që në momentin e lindjes ose gjatë pubertetit dhe adoleshencës. Por ka dhe mënyra të tjera shkencore për ta zbuluar përmes ekzaminimeve mjeksore të ndryshme që përfshijnë:

- Analizat e gjakut menjëherë mbas lindjes;
- Ekzaminimet rutinë të sonogramës në abdominalin e fëmijës;
- Operacioneve rutinë në fëmijëri për riparimin e hernies dhe appendectomisë
- Ndjekjen e zhvillimeve të karakteristikave seksuale gjatë pubertetit;
- Leximin e kujdesshëm të ekografisë gjatë shtatëzanisë;
- Faktin që personat interseks e zbulojnë veten si të tillë në çdo moshë;

## Fëmija im është interseks. Po tani?

Variacionet janë të pranishme kudo në natyrë. Të jesh interseks është e natyrshme dhe nuk duhet të ndiheni të frikësuar. Një nga gjërat më të rëndësishme është të jeni të hapur me fëmijën tuaj dhe ta dëgjoni me vëmendje për nevojat që ka. Sigurisht që do të ballafaqoheni dhe me sfida. Shumë njerëz ende nuk janë në dijeni të ekzistencës së personave interseks, ndaj do t'ju duhet të gjeni mënyra se si ta prezantoni fëmijën dhe nevojat e tij specifike. Për shembull, mund të kërkonit nga stafi shkollor të përkujdeset për ta përfshirë fëmijën edhe në rastet kur ai vetë qëndron i veçuar nga frika e ndonjë ngacmimi të mundshëm.





Fillimisht prindërve i duhet kohë të mësohen me faktin që kanë dhe duhet të kujdesen për një fëmijë interseks. Jepini kohë vetes. Gjatë këtij procesi do t'ju duhet të merrni dhe vendime të vështira si dhënia e miratimit për ndërhyrje kirurgjike ose për procedura të tjera mjekësore, por para se të jepni një vendim të tillë duhet të kërkoni dhe të jeni të mirëinformuar për të gjitha pasojat në shëndetin e fëmijës.

### **A duhet të jap miratimin për ndërhyrje kirurgjikale përpara se të regjistroj fëmijën në zyrën e gjëndjes civile si femër apo mashkull?**

Përpara, por edhe mbas regjistrimit të seksit të fëmijës suaj, mundet që shumë profesionistë të mjekësisë, familjarë ose miq t'ju sugjerojnë që të miratoni trajtimin mjekësor që do t'i japë fëmijës një përcaktim të qartë të seksit si mashkull ose femër. Jo rrallë këto kirurgji "normalizuese" mund të përbëjnë një eksperiencë traumatizuese për fëmijën interseks si dhe mund të passjellin një sërë problemesh shëndetësore gjatë jetës së tyre. Disa argumente të zakonshëm në favor të ndërhyrjeve kirurgjikale përfshijnë:

- Rrezikun e kancerit, nëse ndërhyrjet kirurgjikale nuk realizohen;
- Për fëmijën është më mirë të ndërhyhet në moshë të njomë;
- Ndërhyrjet e hershme janë më pak të rrezikshme;
- Ndërhyrjet minimizojnë presionin shoqëror dhe ndihmojnë fëmijën të përshtatet më shpejt e më mirë;

Përpara se të miratoni çfarëdo ndërhyrje kirurgjikale, është e rëndësishme të dini se deri më tani nuk ekziston asnjë kërkim shkencor që i mbështet argumentet e mësipërme, apo që të provojë se këto kirurgji kanë pasur impakt pozitiv mbi fëmijët interseks krahasuar me ata fëmijë interseks që nuk i janë nënshtruar.

## Fëmija im lindi interseks. Çfarë do të ndodhë në spital?

Nëse foshnja juaj lind interseks (dhe kjo dallohet që në lindje), eksperiencia juaj do të jetë e ndryshme nga ajo e prindërve të tjerë:

- Foshnjën tuaj mund ta marrin për kontroll më shpesh se fëmijët e tjerë. Mos ngurroni të pyesni se ku po e çojnë, sa do të vonohen dhe kur do ta kthejnë. Gjithashtu mund të kërkonti që ta shoqëroni fëmijën tuaj. Pyesni për çdo test që do t'i bëhet fëmijës dhe kërkonti që këto teste të realizohen në praninë tuaj. Prania e prindit ndikon pozitivisht për të qetësuar fëmijën qoftë edhe gjatë analizave të gjakut.

- Përveç kontrolleve rutinore të mjekëve në institucionin e lindjes, takimeve me infermierët dhe mamitë, ju duhet të takoheni dhe me specialistë të tjerë si me endokrinologun e kirurgun e pediatriisë ose sipas nevojës dhe me specialistë të tjerë. Kjo mund të realizohet gjatë kohës që jeni në spital dhe nëse jo, duhet ta bëni privatisht.

- Në fillim do të merrni shumë informacion që është i vështirë për t'u kuptuar, për shkak të mungesës së parapërgatitjes si dhe të terminologjisë teknike . Në këtë rast mos hezitoni të pyesni dhe të qartësoheni para se të jepni miratimin për teste të ndryshme.

- Ekipi mjekësor në spital mund t'ju sugjerojë një sërë trajtimesh mjekësore që përfshijnë dhe gonadectominë (heqja e vezoreve ose testikujve) apo ndonjë kirurgji gjenitale. Ju duhet të shtyni për më vonë çdo kirurgji që nuk është urgjente për shëndetin e fëmijës dhe të kërkonti këshilla të mëtejshme.



Ka shumë trajtime eksperimentale që ndodhin në spitale të ndryshme.

Disa prej tyre tashmë janë gjetur të kenë efekte shqetësuese afatgjata anësore për shëndetin mendor dhe njohjen. Këto përfshijnë administrimin e barnave përpara lindjes, si dhe manipulimin hormonal të fëmijëve të vegjël përmes injeksioneve ose xhelit.

- Nëse fëmija juaj për ndonjë arsye është larguar nga Ju, kërkoni që ata të kthehen menjëherë.
- Kërkoni që çdo testim të bëhet në praninë tuaj dhe të pyesni për arsyet e testeve para se të jepni pëlqimin. (Nëse, për disa arsye, nevojitet një test i gjakut, do të jetë shumë më e lehtë për fëmijën tuaj që kjo të ndodhë me Ju të pranishëm, gati për t'i qetësuar).
- Nëse është e mundur, telefononi një të afërm ose një person të besuar dhe kërkoni nga ata të bashkohen me Ju. Kjo është një kohë e vështirë për të gjithë prindërit e rinj dhe Ju do të keni më shumë për të dokumentuar se të tjerët. Të kesh dikë për të të ndihmuar për të mbajtur shënime dhe për t'ju dhënë një dorë ndihmë mund të jetë shumë e dobishme. Pyesni nëse vendimet mund të shtyhen derisa të keni një person afër.
- Shkruani ose regjistroni sa më shumë informacion që mundeni. Regjistrimi i bisedave tuaja do të thotë që nuk duhet të shqetësohesh aq shumë për marrjen e shënimeve dhe shumica e telefonave sot vijnë me regjistruesit e integruar të zërit ose ka aplikacione që mund të shkarkosh. Në rast se jeni vetëm pas lindjes së fëmijës, regjistrimet mund të ofrojnë një alternativë të vlefshme për një person të dytë kur më vonë të ri-kujtoni informacionin.
- Bëni pyetje, kërkoni shpjegime dhe kërkoni sqarime. Merrni kohën tuaj. Ju nuk mund të merrni vendime pa kuptim. Ndonjëherë na merr një kohë më të gjatë për të kuptuar konceptet dhe terminologjinë e re dhe ke një të drejtë absolute për të kuptuar se çfarë po ndodh.
- Pyesni kur mund të shkoni në shtëpi. Një mjedis shtëpie është një ambient shumë më i mirë sesa një repart spitalor për lidhjen me të lindurin tuaj. Në shumicën e rasteve, Ju duhet të jeni në gjendje të shkoni në shtëpi në një kornizë kohore të ngjashme me prindërit e tjerë. Nëse për ndonjë arsye, ky nuk është rasti, pyesni pse. Nëse arsyeja është që ata janë duke pritur që të vijnë rezultatet e analizave, atëherë pyesni nëse mund të shkoni në shtëpi dhe të ktheheni kur analizat të mbërrijnë. Insistoni për një përgjigje nëse nuk ju lejojnë të shkoni në shtëpi.


## Nëse mjekët sugjerojnë të merrni një vendim sa më shpejt të jetë e mundur, si duhet të veproni?

Menjëherë pas lindjes, nuk është e këshillueshme të nxitoni për të marrë vendime për disa arsye si: ju dhe partneri juaj po perballeni me një situatë të pazakonshme, që shoqërohet me emocione të shumëllojshme, duke shtuar këtu edhe ato të shkaktuara nga lindja në vetvehte, siç janë ndryshimet hormonale, që ndikojnë mirëqenien tuaj. Këta faktorë tregojnë se nuk është koha ideale për të marrë vendime që mund të sjellin pasoja për të ardhmen e fëmijës suaj.

Disa trajtime mjekësore janë të nevojshme për t'u realizuar menjëherë në dobi të shëndetit të fëmijës. Por një pjesë e mirë e trajtimeve mjekësore nuk bazohen në nevoja urgjente, ato kanë të bëjnë me aspektin social apo kozmetik të problemit. Këtu përfshihen kirurgjitë që ndryshojnë pamjen e gjenitaleve të jashtme të fëmijës meqë ato nuk shfaqen si shumica e gjenitaleve të fëmijëve të tjerë. Pikërisht për këtë kategori ndërhyrjesh nuk është e nevojshme të nxitoni.

## Si të kuptoj cila është alternativa më e mirë për fëmijën tim interseks?

Nuk janë të gjitha situatat të njëjta. Nisuni gjithmonë nga mirëqenia dhe shëndeti i fëmijës suaj. Kërkoni të merrni mendim nga persona interseks më të rritur, pasi ata kanë mësuar shumë nga përvoja e tyre. Mos u ndikoni dhe nxisni për vendime të pamenduara mirë. Nuk humbisni asgjë të vendosni në një moment të dytë kur vetë fëmija juaj është në gjendje t'ju ndihmojë të vendosni. Kërkoni ndihmë edhe nga organizata që punojnë për të drejtat e personave interseks, ato do t'ju vendosin në kontakt me prindër të tjerë që kanë eksperiencë me fëmijë interseks.



## **A është më e lehtë të operosh fëmijën ndërsa është ende foshnjë?**

Nëse ndërhyrja kirurgjikale ju paraqitet si alternativa më e mire për foshnjën tuaj, është e rëndësishme të pyesni dhe mësoni për efektet anësore që një ndërhyrje e tillë mund të shkaktojë në këtë moshë. Përveçse duhet të siguroheni që vendosja nën anestezi të plotë e foshnjës nuk do të mbart rreziqe, ju duhet të informoheni mirë:

- Për rrezikun që fëmija mund të humbasë funksionalitetin e organit të operuar;
- A shoqërohen këto operacione në moshë të vogël me efekte negative anësore si mpirje, dhimbje apo impotencë;
- A shkaktojnë ato nevojën për ndërhyrje të tjera ose akoma më keq kushtëzimin e vazhdueshëm për ndihmë mjeksore; ndërhyrjet kirurgjikale "normalizuese" nuk përcaktojnë përfundimisht seksin mashkull apo femër, ato thjeshtë ndryshojnë pamjen ose funksionalitetin e organeve deri në një fare mase.

## **Nëse nuk jap miratim për ndërhyrjet kirurgjikale, a do të jetë funksional trupi i fëmijës tim?**

Praktika tregon se personat interseks që nuk i janë nënshtruar ndonjë ndërhyrjeje kirurgjikale, gëzojnë shëndet të plotë. Sipas disa studimeve për këtë qëllim, del se shumica e personave interseks që i janë nënshtruar kirurgjive "normalizuese", është ballafaquar me probleme shëndetësore për shkak të këtij trajtimi. Kirurgjia rekomandohet vetëm në rast se shëndeti i fëmijës rrezikohet. Prisni derisa fëmija të jetë rritur mjaftueshëm për t'u përfshirë në vendimarrjen për ndërhyrjet kirurgjikale.

## Si duhet ta regjistroj gjininë e fëmijës tim interseks në zyrën e gjendjes civile?

Fakti që jetojmë ende në kushtet kur organet ligjvënëse dhe ekzekutive nuk e njohin ligjërisht diversitetin e karakteristikave seksuale tek njerëzit, të detyron për ta regjistruar fëmijën ose si mashkull, ose si femër në shumicën e vendeve. Shtete të ndryshme kanë legjislacione të ndryshme për plotësimin e gjinisë në regjistrin themeltar të gjendjes civile. Në vende ku vetëm opsionet mashkull ose femër janë të mundura, organizatat interseks rekomandojnë që prindërit të regjistrojnë fëmijën me seksin që ju përshtatet më shumë, duke i dhënë kohë fëmijës që gjatë procesit të rritjes të kuptojë dhe ndjejë identitetin e tij gjinor.

## Me cilën gjini duhet ta rris fëmijën tim?

Organizatat interseks rekomandojnë që fëmija duhet rritur ose si mashkull, ose si femër meqë kjo është mënyra se si shoqëria jonë është e strukturuar. Por në të njëjtën kohë, duhet të jeni të përgatitur që identiteti gjinor që zhfaqet gjatë rritjes mund të mos përputhet me identitetin që i është vendosur paraprakisht në momentin e lindjes. Nuk ka asgjë të gabuar me këtë mospërputhje, thjeshtë fëmija do të kuptojë vetë më qartë se si ndihet dhe si dëshiron të identifikohet në përputhje me personalitetin individual.



## **A përbën interseksualizmi çrregullim?**

Të qenurit interseks është vetëm pjesë e diversitetit të trupit njerëzor. Të qenurit interseks nuk përbën as çrregullim, as ndonjë dëmtim fizik.

## **A duhet t'i tregoj fëmijës tim që është interseks?**

Po! Individët interseks në moshë madhore, kuptojnë dhe tregojnë se janë rritur me stigmën, turpin dhe sekretin që duhet të mbanin për shkak të karakteristikave seksuale. Kjo mënyrë jetese ka ndikuar negativisht në jetën e tyre personale, shoqërore dhe intime. Kur prindërit kanë qenë të hapur me fëmijën e tyre interseks, kanë ndikuar pozitivisht në anën psikologjike, në rritjen e vetëbesimit dhe në harmoninë e marrëdhënieve familjare e sociale. Është shumë e rëndësishme që fëmija të ndjejë dashurinë e prindërve dhe që sjellja e tyre është e njëjtë dhe pa dallime nga pjestarët e tjerë në familje.

## **A duhet t'ju tregoj të tjerëve që fëmija im është interseks?**

Vendimi për t'i treguar të tjerëve mbetet një zgjedhje personale. Duhet vetëm të merrni në konsideratë se si do të ndikojë kjo gjë në jetën e fëmijës. Duhet theksuar që fakti i të mbajturit sekret nuk është zgjedhja më e mirë sepse kur shkoni me fëmijën tek mjeku apo infermjerja, në kopësht apo shkollë, nuk duhet të krijoni situatë kompleksive për fëmijën tuaj. Mirëqënia e fëmijës e kërkon inkurajimin për të treguar e folur rreth të qenit interseks si një normalitet edhe pse i ndryshëm nga fëmijët e tjerë. Shumë prindër që kanë vepruar në këtë mënyrë demonstronjë se ndaj fëmijës janë shmangur format e mënjanimit, neglizhimit apo diskriminimit dhe ai është rritur e ndjerë në një mjedis të sigurtë. Sigurisht për këtë duhet të jeni të informuar dhe përgatitur që t'i përgjigjeni të gjitha pyetjeve, edhe atyre private.

# Marrja e vendimeve rreth ndërhyrjeve kirurgjikale

Për këtë prindërit duhet t'i bëjnë vetes pyetje si: A ka nevojë fëmija im për ndërhyrje kirurgjikale? A po vuan ai ndonjë gjendje fizike që cënon aktivitetin normal dhe rrezikon jetën e tij?

Po listojmë më poshtë disa situata fizike që kërkojnë dhe justifikojnë ndërhyrjen e menjëhershme kirurgjikale dhe disa të tjera për të cilat ndërhyrja kirurgjikale nuk është e nevojshme.

1. Ndërhyrja kirurgjikale mund të jetë e nevojshme në rastet kur konstatohet:

## **Hyponatremia (Niveli i ulët i kripës në gjak)**

Ky fenomen mund të shkaktohet si pasojë e një variacioni në trup të quajtur Congenital Adrenal Hiperplasia (CAH). Ndërhyrja kirurgjikale është e nevojshme si pasojë e mungesës së mineraleve tek fëmijët. Kjo lloj ndërhyrjeje do ta nxjerrë jashtë rrezikut fëmijën por nuk duhet anashkaluar fakti që mund të ketë në të ardhmen incidente në rast se nuk merren medikamente apo nuk ka ekzaminim mjekësor.

## **Uretra e mbyllur**

Kur fëmija ka lindur me një uretër të mbyllur (tubi që derdh urinën nga fshikëza jashtë), atëhere urina nuk mund të dalë jashtë trupit. Në këto raste, kirurgjia e menjëhershme është e nevojshme për të parandaluar helmimin e trupit të fëmijës.



## 2. Ndërhyrja kirurgjikale është e pa nevojshme për:

### Heqjen e gjëndrave seksuale

Ndonjëherë mjekët sugjerojnë që të bëhet ndërhyrje kirurgjikale për heqjen e gjëndrave seksuale për të parandaluar rrezikun e kancerit. Por nuk ka ndonjë studim që të japë përqindjen e rrezikut të personave intersex të ballafaquar me sëmundjen e kancerit. Kujtojmë këtu për paralelizëm se frika nga kanceri i gjirit nuk i ka detyruar të gjitha gratë të heqin gjirin.

Eliminimi i testikujve apo vezoreve tek fëmija do të pengonte ata të kishin një pubertet normal. Për më tepër, nëse këto gjëndra hiqen atëherë fëmija është i detyruar t'i nënshtrohet terapisë hormonale për të nxitur pubertetin. Kjo duhet të shoqërohet dhe me vizita rutinore tek mjeku gjatë adoleshencës së fëmijës. Për arsye të ndryshme disa nga personat interseks nuk mund të ndjekin terapinë hormonale, gjë që më pas sjell komplikime të tjera në shëndet. Hormonet janë vitale për shëndetin e kockave dhe mungesa e një terapie hormonale pas heqjes së gjëndrave mund të shkaktojë osteoporozën. Shumë persona interseks që kanë kaluar një ndërhyrje të tillë kirurgjikale raportojnë për raste të osteoporozës.

### Për kirurgji gjenitale

Të gjithë ne kemi një lloj imazhi në kokën tonë të pamjes që duhet të kenë organet mashkullore apo femërore, por ende nuk jemi në dijeni të variacioneve të shumta të karakteristikave seksuale. Organet gjenitale të personave interseks shpeshherë ndryshohen për t'ju përshtatur modelit dualist mashkull/femër. Kjo lloj ndërhyrje realizohet për disa arsye si:

- Për t'ju përshtatur më mirë normave shoqërore duke u rritur ose si mashkull ose si femër;
- Për të patur jetë seksuale të shëndetshme dhe organe gjenitale që së jashtmi janë sipas modelit shoqëror dualist;
- Për të riprodhuar dhe krijuar familje;

Disa profesionistë të mjeksisë dhe të fushës kanë adresuar çështjen e ndërhyrjeve kirurgjikale të hershme dhe kanë nënvijëzuar se ky trajtim mund të shtyhet për një fazë të mëvonshme, kur trupi të jetë gati dhe vetë fëmija të jetë në gjendje për të vendosur dhe miratuar ndërhyrjen.

## Disa Konkluzione

Bazuar në informacionin e dhënë më sipër rezulton se për një numër të vogël rastesh kirurgjia mund të jetë e nevojshme, por në shumicën e rasteve të fëmijëve interseks këto kirurgji nuk janë të nevojshme, edhe kur ato prezantohen para prindërve si domosdoshmëri. Prandaj është e nevojshme të kenë siguruar informacion të bollshëm para se të jepni miratimin si prind për ndërhyrje kirurgjike. Sot pjesa më e madhe e aktivistëve interseks dhe organizatave që kanë në fokus këtë kategori, rekomandojnë që këto kirurgji të realizohen vetëm me miratimin e personave interseks, në një moshë kur janë të pjekur dhe të aftë për të vendosur për trupin e tyre.

Mjekët specialistë jo rrallë keqinformojnë prindërit duke theksuar se mosrealizimi i ndërhyrjeve kirurgjikale do të sjelli probleme psikologjike tek fëmija, ngaqë gjinia është e papërcaktuar. Në fakt nuk ekziston ndonjë evidencë shkencore që të argumentojë pasojat psikologjike të fëmija në rast mosndërhyrjeje kirurgjike. Ka të dhëna në rritje që vetë personat interseks pohojnë se kjo kirurgji nuk është e nevojshme. Madje ata që nuk i janë nënshtruar ndonjë kirurgjie kanë patur jetë të shëndetshme. Përkundrazi ata që i janë nënshtruar këtyre kirurgjive kanë vuajtur dhe dëmin psikologjik që ka ardhur si pasojë e tyre.

Nëse një mjek ju tregon se kirurgjia ose ndonjë lloj tjetër ndërhyrje mjekësore është e nevojshme, kërkoni nga ata t'ju:


- Shpjegojnë në detaje se çfarë duhet të ndodhë dhe pse;
- Përkraajnë rreziqet e të dyve si pasojë e ndërhyrjes dhe mos bëni asgjë në këtë fazë;
- Tregojnë se ku mund të merrni më shumë informacion.

Pas një takimi me një mjek që rekomandon ndërhyrje mjekësore:

- Vihuni në kontakt me një organizatë interseks ose me një grup prindërisht për këshilla, informacion dhe mbështetje;
- Merrni ndihmë për të gjetur një mjek që mund të japë një mendim të dytë;
- Bëni hulumtimet tuaja, rishikoni shënimet tuaja dhe sigurohuni që të kuptoni plotësisht gjithçka që u tha gjatë vizitës;

Nëse fëmija juaj ose Ju vendosni që ndërhyrja mjekësore është e nevojshme:

- Pyesni mjekun t'ju shpjegojë se çfarë do të ndodhë në detaje;
- Pyesni mjekun t'ju tregojë nëse do të nevojiten ndërhyrje të mëtejshme dhe rreziqet që lidhen me to;
- Pyesni mjekun se çfarë lloj ndihme psikologjike (apo të tjera) janë në dispozicion për fëmijën tuaj (dhe Ju) nëse është e nevojshme;
- Kërkoni këshilla, informacion dhe mbështetje nga një organizatë interseksuale.



# Si të flasësh me fëmijën tënd interseks

Edhe pse është e rëndësishme të mos e bësh fëmijën të ndjehet i ndryshëm në mënyrë negative apo të shqetësohet pse është interseks, të mos flasësh fare me të është po aq problematike.

## Si dhe kur mund të flisni me fëmijën tuaj?

Edhe pse fillimisht mund të gjykoni që është më mirë apo më e lehtë që fëmijëve t'ju komunikohet në moshë madhore fakti që ata janë interseks, të zbuluarit me vonesë mund të shoqërohet me komplikacione ose gjendje "shoku" prandaj është e këshillueshme:


- Përpjekja për t'ju përgjigjur të gjitha pyetjeve që fëmija të mos gjendet i papërgatitur;
- Nuk është nevoja t'i shpjegoni që në fillim fëmijës termat biologjike, por mundet gradualisht të përdorni shprehje si "jo të gjitha vajzat apo djemtë janë njëlloj";
- Të përgatisni fëmijën për sfida dhe vështirësi që mund të ndeshen gjatë rritjes dhe që do t'i kaloni bashkë të gjitha vështirësitë;
- Mbështesni dhe inkurajoni fëmijën gjatë periudhave delikate, duke theksuar se çdo person ballafaqohet me sfida;
- Të parashikoni që një ditë fëmija do rritet dhe duhet të bëhet i pavarur, prandaj ka nevojë të dijë të gjitha faktet rreth trupit të vet në mënyrë që të marrë një vendim në të ardhmen.

## Si të përballojmë stigmën shoqërore?

Prindërit e fëmijëve interseks e vrasin mendjen se si do të komunikojnë me të tjerët. Bëni kujdes! Në asnjë moment mos lejoni që fëmija të mendojë se kjo duhet të përbëjë sekret. Nëse fëmija juaj mendon se të qenit interseks duhet mbajtur e fshehtë atëherë ata do të kujtojnë që ka diçka të gabuar tek ata. Lëreni fëmijën të njihet me të gjitha faktet rreth trupit në mënyrë pozitive, dhe se edhe pse të ndryshëm mund të jenë të shëndetshëm, të lumtur pa u kategorizuar detyrimisht si mashkull apo femër.

Përpiquni të shpjegoni se të qenit interseks nuk është e pazakonshme, në mënyrë që të evitoni ndjesitë e izolimit. Nëse fëmija dëshiron të dalë hapur si interseks, mbështeteni këtë vendim, por edhe nëse nuk dëshiron të dalë hapur, përsëri mbështeteni. Mos e prezumoni identitetin gjinor apo orientimin seksual të fëmijës suaj interseks. Sikurse të gjithë fëmijët, identiteti i tyre gjinor apo/dhe orientimi seksual mund të jetë shumë ndryshe nga çfarë ju prisni.

Shumë individë nuk janë në dijeni të diversitetit që karakterizon shoqërinë tonë, ndaj personat interseks kanë qenë të padukshëm për një kohë të gjatë. Është shumë e rëndësishme të investoni në rritjen e vetë-besimit të personave interseks dhe në dashurinë prindërore e mbështetjen.



## Vendim-marrja

- Edhe pse në pamje të parë duket sikur çdo ndërhyrje e hershme tek fëmijët interseks është vendimi më i mirë, eksperiencia tregon se e kundërta është e vërtetë. Këshillohet që të prisni derisa fëmija të arrijë moshën që të marrë vetë vendimin. Fëmijët nisin të shprehin mendimet e tyre dhe të ndërgjegjësohen rreth moshës 2 vjeç ndaj rekomandohet përfshija e tyre në çdo vendim.
- Sigurohuni që mjekët të mos t'ju 'bombardojnë' me informacion, Ju ose fëmijën tuaj. Kjo mund të ndodhë thjeshtë për shkak të terminologjisë mjekësore që përdorin, duke qenë se ata janë ekspertë në këtë situatë. Kur është e mundur, sillni një mik ose një anëtar të familjes me Ju për t'ju ndihmuar të diskutoni mundësitë dhe të merrni vendime.
- Diskutoni të gjitha mundësitë me fëmijën tuaj, duke e lënë kirurgjinë si opsionin e fundit (nëse nuk ka implikime të menjëhershme shëndetësore).
- Ndani të gjithë informacionin në lidhje me rreziqet dhe rezultatet e mundshme në një mënyrë të përshtatshme për moshën.
- Jepini akses në të dhënat e tyre mjekësore. Ata kanë të drejtë të dinë.
- Përgjigjuni të gjitha pyetjeve të tyre. Tregojini thelbin dhe mundësojini të bëjnë edhe hulumtimet e tyre. Mësojini vetes dhe atyre vetë se si të bëjnë hulumtime të mira - si të identifikoni informacionin e vlefshëm dhe të shmangni keqinformimin.
- Sigurojini fëmijës tuaj se janë ata që e dinë më mirë se si ndihen për jetën dhe trupin e tyre, por që ka ndihmë dhe mbështetje në dispozicion nëse kanë nevojë për to.
- Përfshini fëmijën tuaj në bisedat me mjekët. Inkurajojini ata që të bëjnë pyetje dhe të shqyrtojnë në mënyrë kritike këshilla dhe informacione.
- Fuqizimi i fëmijës suaj që të ketë nën kontroll çdo ekzaminim mjekësor apo ndërhyrje, si dhe se pëlqimi i tyre duhet të jepet në çdo fazë. Kërkoni dhe mësojini atyre të drejtat e tyre të pacientit.
- Kur bëhet fjalë për ekzaminime mjekësore, sigurohuni që profesionistët e mjekësisë të dinë se fëmija juaj është interseksual.

- Duhet gjithmonë të jeni të pranishëm gjatë gjithë ekzaminimeve mjekësore që mund t'i nevojiten fëmijës juaj, përveç rasteve kur fëmija është i madh në moshë dhe kërkon ndryshe.
- Jepini fëmijës tuaj kohë dhe hapësirë për t'u përgatitur dhe për t'u marrë me gjërat siç janë ekzaminimet mjekësore që mund të jenë të frikshme.
- Në përgjithësi, besoni fëmijën tuaj - ata janë shumë të aftë për vendimmarrje të pëgjegjshme nga sa mund ta mendoni.

## **Mbështetja**

- Mos harroni se nuk jeni vetëm dhe se Ju dhe fëmija juaj mund të kenë nevojë për mbështetje shtesë nga të tjerë, në faza të ndryshme.
- Fëmija juaj duhet të dijë se ekzistojnë mundësi të ndryshme mbështetëse për ta, duke përfshirë grupet e interseksit, këshillimi dhe terapia, marrja e ndihmës kur keni nevojë nuk është një shenjë dobësie, por një hap pozitiv në kujdesin për veten.
- Inkurajoni fëmijën tuaj për të gjetur dhe për t'u bashkuar me grupe mbështetëse, nëse duan. Le ta dinë që ndarja e përvojave të jetës me njerëz të tjerë interseks është një nga mënyrat më të mira për t'i ndihmuar ata të kuptojnë rezultatet e mundshme të vendimeve të tyre dhe të gjejnë një vend të sigurt për të shqyrtuar se çfarë do të thotë interseks. Të rinjtë që përdorin rrjetet sociale mund të drejtohen në grupet mbështetëse online. Megjithatë, përpara se fëmija juaj të bashkohet me një grup mbështetës, bëni hulumtimin tuaj për të siguruar që ato të jenë të miratuar nga një organizatë interseksuale.
- Si prind ose kujdestar, do të ketë raste kur keni nevojë për mbështetje shtesë. Megjithëse mundet që mos të ketë një grup të veçantë për prindërit e fëmijëve interseks në zonën tuaj, shikoni grupime apo mundësi të tjera.

# Si të flasësh me të tjerët për fëmijën tënd interseks

## Miratimi

Fëmijët nisin të ndërgjegjësohen dhe të shprehin mendimet e tyre rreth moshës 2 vjeç, ndaj përfshijeni fëmijën tuaj në vendimarrje sa më shpejt që të jetë e mundur. Pyeteni fëmijën se si ndihet për faktin e të treguarit të tjerëve që janë interseks. Rikujtoji fëmijës që nuk ka asgjë për të cilën të ndihen të turpëruar, por nga ana tjetër duhet t'i shpjegoni se disa persona mund të kenë reagime të çuditshme ndaj interseksualizmit për shkak të mungesës së informacionit.

## Jini krenarë!

Kur flisni me të tjerët për fëmijën tuaj interseks, sigurohuni që ta bëni me ton që mos të tingëllojë si sekret apo si diçka për të cilën turpëroheni. Edhe pse mund të merrni reagime negative apo të sikletshme, duhet të tregoni se nuk ka asgjë të gabuar, vetëm në këtë mënyrë njerëzit mund të ndryshojnë perceptimet ose mungesën e informacionit për këtë subjekt. Sa më të hapur dhe krenarë të jenë prindërit e fëmijëve interseks, aq më shumë ndërgjegjësim do të ketë në shoqëritë tona.





## Tregoni durim

Për shumicën e personave termi interseks mund të jetë i ri dhe jo shumë i kuptueshëm në fillim. Merrni kohën e duhur për të bërë shpjegimet e nevojshme. Tregojuni se të qenurit interseks është plotësisht normale. Bëhuni gati për reagimet e sikletshme dhe negative, duke ju përgjigjur me qetësi dhe pozitivitet. Shumica e këtyre reagimeve vjen si pasojë e mungesës së informacionit rreth interseksualizmit dhe stigmës shoqërore që e ka konsideruar si anomali ndër vite. Përdorni terma të thjeshtë dhe terminologji jo të vështirë për t'u kuptuar.

## Të flasësh me anëtarët e tjerë të familjes

Nëse keni fëmijë të tjerë, është e rëndësishme të flisni me ta rreth asaj se çfarë do të thotë të jesh interseksual. Nëpërmjet bisedave të përgjithshme rreth dallimeve dhe diversitetit ju mund të prezantoni gradualisht atë që do të thotë të jesh interseksual. Ashtu siç i mësoni fëmijës suaj interseksual si t'i përgjigjet bullizmit apo ngacmimeve, është po ashtu e rëndësishme t'u mësohet vëllëzërve e motrave të bëjnë të njëjtën gjë, pasi ata mund të përjetojnë të njëjtën gjë. Kur bëhet fjalë për anëtarët më të rritur të familjes mos supozoni automatikisht se edhe me ata do të jetë domosdoshmërisht e vështirë për të biseduar. Për shembull, vlera të tilla si trajtimi i të gjithëve me respekt ose pranimi i asaj që na paraqet jeta, mund të përdoret për t'ju qasur personave me besime më tradicionale. Edhe nëse keni ndonjë hezitim nga një anëtar i familjes për të pranuar ose diskutuar për fëmijën tuaj interseksual, jepni personit kohë dhe kërkoni nga anëtarët e tjerë të familjes të cilët kanë pranuar t'ju ndihmojnë të flisin me ta. Inkurajojini ata që të mësojnë më shumë për të qenit interseks përmes artikujve, dokumentarëve ose llogarive personale. Sa më shumë të dinë për çështjen, aq më shumë ka gjasa që ata të jenë pranues dhe mbështetës.

## Bëhuni aleatë

Nëse fëmija juaj është i kënaqur me këtë gjë, përpiquni të ngrini ndërgjegjësimin për njerëzit interseksualë kudo që të mundeni. Gjeni mundësi për të ngritur temën e interseksit me grupe të ndryshme njerëzish ose për të postuar artikuj përkatës. Nëse njerëzit thonë diçka të pasaktë ose fyese për njerëzit interseks, përpiquni t'i korrigjoni ato në një mënyrë të sjellshme dhe miqësore, por të vendosur. Një mundësi tjetër është të bashkoheni ose të mbështesni një organizatë interseks për të ndihmuar në rritjen e vizibilitetit në shoqëri dhe përparimin e të drejtave të personave interseks.

# Pyetje që të tjerët bëjnë për fëmijën tuaj interseks

## A është foshnja juaj djalë apo vajzë?

Mënyra se si do t'i përgjigjeni kësaj pyetjeje varet nga mënyra se si do ta rrisni fëmijën tuaj. Nëse po e rrisni si vajzë apo djalë, atëherë mund t'i jepni lehtësisht përgjigje pyetjes. Nëse nuk jeni të sigurtë për identitetin gjinor të fëmijës, mund të shpreheni se po e rrisni fëmijën në një mënyrë që t'ja lini në dorë fëmijës të zgjedhi vetë identitetin me të cilin identifikohet.

## Çfarë shkoi gabim?

Jo, asgjë nuk shkoi gabim! Rreth 1.7% e lindjeve në botë kanë karakteristika seksuale të ndryshme nga ato lehtësisht të cilësuar si vajzë apo djalë. Problemi i vetëm është që nuk është folur mjaftueshëm në shoqëritë tona për këtë gjë.

## Pra fëmija juaj është hermafrodit?

Jo! Hermafroditët gëzojnë plotësisht organet femërore si dhe atë mashkullore, dhe kjo është e pamundur tek qeniet njerëzore. Ndërkohë personat interseksual kanë variacione në karakteristikat seksuale që nuk përputhen me normat e trupave femërore apo mashkullore.



## **A përbën interseksualizmi një çrregullim?**

Interseksualizmi thjeshtë përbën diversitet në trupat njerëzorë, sikurse variacionet në shtatlartësi apo ngjyrën e flokut.

## **Si duken gjenitalet e bebes suaj interseks?**

Një këshillë ndaj personave që bëjnë këtë pyetje: A nuk ju duket një pyetje jo fort e hijshme për tu bërë? Edhe fëmija më i vogël ka të drejtën e privatësisë.

## **A duhet t'a operoni fëmijën tuaj interseks?**

Shumë persona interseks do të rriten pa pasur nevojën e ndonjë ndërhyrjeje kirurgjikale.

E vetmja gjë që duhet, është mirëkuptim dhe pranim shoqëror, pasi personat interseksual ende shihen si të ndryshëm dhe kjo sjell episode bullizmi dhe diskriminimi.

## **Çfarë orientimi seksual kanë personat interseks?**

Nuk ka asnjë ndërlidhje midis karakteristikave seksuale dhe orientimit seksual, ndaj personat interseks mund të jenë lezbike, gej, biseksualë ose çdo orientim tjetër seksual.

## **Cili është identiteti gjinor i personave interseks?**

Shumë persona interseksuale mund të identifikohen si vajzë apo djalë, në përputhje me gjininë që i është përcaktuar në lindje. Ndonjëherë këta persona e kuptojnë teksa rriten, që identifikohen me një identitet tjetër gjinor, të ndryshëm nga ai që i përcaktohet në lindje. Shumë të tjerë mund të vendosin të kenë identitet jo binar (non-binary person).

# Të flasësh me mësuesit, mjekët dhe profesionistë të tjerë për fëmijën tuaj interseks

Në momente të ndryshme të jetës së fëmijës tuaj, duhet të merrni vendime se cilët profesionistë duhet të dinë për fëmijën tuaj interseksual dhe sesi do të qaseni ndaj tyre.

Është e rëndësishme që të përfshini fëmijën tuaj në procesin e vendimmarrjes sa më shpejt që të jetë e mundur. Fëmijët shumë të vegjël mund të shprehin preferencat dhe mendimet, nëse kërkohen në mënyrën e duhur. Ndërsa fëmija juaj nuk do të jetë në gjendje të trajtojë të gjitha aspektet e vendimmarrjes në një moshë shumë të re, është e rëndësishme që ata të fillojnë trajtimin e aspekteve që mundën sa më shpejt që të jenë në gjendje. Kjo do t'i fuqizojë ata dhe do t'u japë atyre një ndjenjë më të fortë kontrolli mbi jetën e tyre. Në këtë kapitull do të gjeni disa udhëzues për planifikim dhe diskutime me mësuesit, mjekët dhe profesionistët/të rriturit e tjerë të cilët do të krijojnë kontakt me fëmijën tuaj.

## 1. Mjekët dhe stafi mjekësor

Profesionistët e parë që Ju dhe fëmija juaj do të përfshini ka shumë gjasa të jenë mjekë dhe stafi mjekësor. Marrja e vendimeve në lidhje me ndërhyrjet mjekësore është trajtuar në këtë material, kështu që në vijim do të përqendrohemi në kontrollet periodike dhe vizitat e tjera mjekësore.

Kur zgjidhni një mjek për fëmijën tuaj, kontrolloni nëse ata janë të informuar për individët interseksualë ose të paktën të hapur për të mësuar. Sigurohuni që të ndiheni të qetë me ta përpara se të merrni fëmijën tuaj për ta regjistruar dhe për t'u takuar me ta. Nëse fëmija juaj është më i madh në moshë, inkurajojini ata që të jenë pjesë e procesit të seleksionimit / përzgjedhjes, duke i lënë ata të vendosin nëse është mjeku i duhur për ta.

Bëni një listë pyetjesh përpara takimit dhe mbani shënime gjatë takimit për kujtesë. Gjithashtu, ju mund të dëshironi të regjistroni bisedën, me lejen e mjekut tuaj, në mënyrë që të mund të ktheheni dhe të dëgjoni përsëri bisedën për sqarime të pikave që nuk i kujtoni nga takimi. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë kërkoni nga mjeku që të shkruani çfarëdo fjalësh, terma ose fjali të cilat nuk i kuptoni plotësisht.

- Gjithmonë konsultohuni me fëmijën tuaj nëse duan që ju të jeni me ta në zyrën e mjekut ose jo. Në përgjithësi, prindërit janë të pranishëm, përveçse kur kërkohet në mënyrë të shprehur nga fëmija, që të mos jeni të pranishëm.
- Pyesni mjekët ku mund të gjeni më shumë informacion rreth biologjisë së veçantë të fëmijës suaj. Bëjini të ditur mjekut burimet që keni gjetur.
- Sigurohuni që të bëni kopje të kartelës mjekësore të fëmijës suaj: dokumentet dhe rezultatet e testeve mjekësore.
- Qendroni me fëmijën tuaj dhe bëni çmos për të parandaluar ndonjë test ose vizitë të panevojshme nga mjekët të cilët nuk kanë nevojë të vizitojnë fëmijën tuaj.

Nëse një mjek profesionist rekomandon një ndërhyrje kirurgjikale, atëherë kërkoni nga ata që të shpjegojnë nëse është e rëndësishme për shëndetin fizik të fëmijës ose nëse është e një natyre 'kozmetike'. Mos vendosni për këtë gjë, bazuar në përgjigje të paqarta siç është "do të jetë më mirë në këtë mënyrë"; kërkoni gjithmonë informacion të qartë. Regjistroni informacionin ose merrni shënime. Gjithmonë kërkoni një mendim të dytë, përpiquni të kontaktoni me organizatat interseksuale ose prindërit e fëmijëve interseksualë.

## 2. Mësuesit dhe Stafi i Shkollës

### Fëmijët e vegjël

Mund të mos jetë e nevojshme për të diskutuar asgjë me stafin e shkollës. Kjo varet nga fëmija juaj dhe gjendja juaj personale. Nëse fëmija juaj është i hapur për të folur për të qenit interseksual dhe ka të ngjarë ta përmendë këtë gjë në shkollë, atëherë është më mirë të flisni paraprakisht me mësuesin e tij dhe me

drejtuesin e kopshtit, çerdhes ose shkollës. Ju duhet të kuptoni nëse ata kanë informacion për të qenit interseksual (ose ka gjasa të jenë të gatshëm të marrin informacion për këtë gjë), diskutoni për skenarët e mundshëm që mund të lindin dhe dakordësohuni sesi duhet të trajtohen këto skenarë. Nëse fëmija juaj nuk mendon shumë për të qenit interseksual e përmend këtë gjë rrallë ose fare, në këtë pikë nuk ka nevojë të informohet stafi i shkollës. Nëse fëmija juaj ka nevojë për ilaçe ose ka nevojë për ndonjë lehtësi specifike për ndryshimin/përdorimin e banjës, atëherë planet për ta trajtuar këtë gjë duhet të miratohen me stafin e nevojshëm. Kujtojini stafit të shkollës se fëmija juaj ka të drejtën e privatësisë dhe se çdo informacion i marrë duhet të trajtohet në mënyrë konfidenciale, duke e ndarë atë vetëm me personat që duhet ta dinë. Informohuni për rregulloret dhe udhëzimet që janë në fuqi në zonën tuaj.

## Fëmijët më të rritur

Përpara se fëmija të fillojë shkollën e mesme ose universitetin, bisedoni me fëmijën tuaj se si do të dëshironte që situata të menaxhohej. Nxitini ata të mendojnë për pro dhe kundër qasjeve të ndryshme dhe cilat mund të jenë disa nga pasojat, kështu që ata mund të marrin një vendim të informuar. Nëse ata vendosin që një takim me shkollën ose institucionin para se të fillojnë është plani më i mirë, inkurajojini ata që të përfshihen në takim dhe mbështetini për të marrë drejtimin në diskutime duke planifikuar atë që ata duan të thonë dhe duke u përgatitur për çdo pyetje që mund të bëhet.

Është mirë të pyesësh shkollën nëse ata kanë një politikë kundër ngacmimit dhe të diskutoni sesi i trajtojnë rastet që ndodhin. Gjithashtu vlen të pyesësh për mbështetjen e nxënësve dhe cilat shërbime ose grupe janë në dispozicion të nxënësve që mund të jenë të dobishme.

Nëse fëmija juaj do të jetë i hapur për të qenë interseksual, diskutoni mënyra të ndryshme për ngritjen e temës me stafin dhe bini dakord se si ata mund ta mbështesin fëmijën tuaj për ta bërë këtë në një mënyrë që të jetë pozitive dhe e sigurt. Mendoni për mënyrat që ju dhe stafi mund të vëzhgoni fëmijën tuaj në një mënyrë jo ndërhyrëse për të siguruar që ata nuk po përjetojnë asnjë pasojë negative për të qenë hapur interseksualë.

Nëse fëmija juaj nuk dëshiron të zbulojë se është interseksual apo zgjedh ta zbulojë këtë informacion vetëm për disa individë të besuar, flisni për mënyrën si të menaxhojnë rastet kur kjo gjë zbulohet aksidentalisht.

### 3. Profesionistë të tjerë

Profesionistët e tjerë të cilët mund të përfshihen në jetën e fëmijës suaj mund të përfshijnë punonjës socialë, punonjës me të rinjtë, trajnerë sportivë, drejtues fetarë ose psikologë. Dhënia e informacioneve shpjeguese për fëmijën tuaj intereseksual zakonisht ndjek udhëzime të ngjashme si ndaj mësuesve. Merrni parasysh se sa kohë shpenzon fëmija juaj me personin në fjalë dhe në çfarë konteksti. Në përgjithësi nuk ka nevojë të diskutoni që fëmija juaj është intereseksual me shumë nga profesionistët e mësipërm, përveçse nëse ka gjasa që fëmija të nxisë diskutimin ose dëshiron t'i tregojë atyre. Përveç kësaj, e vetmja arsye tjetër për të cilën duhet të diskutohet është nëse ka ndonjë kërkesë specifike për fëmijën tuaj, si p.sh. një ambient privat për t'u ndërruar.

Nëse fëmija juaj ka nevojë të takojë një psikolog ose një profesionist tjetër të shëndetit mendor, atëherë këshillohet që ta diskutoni këtë me ta dhe fëmijën tuaj para se të takoheni. Jo të gjithë profesionistët e shëndetit mendor do të kenë njohuri për të qenit intereseksual, kështu që mund të kërkojnë disa informacione ose udhëzime rreth trajtimit të temës. Kur diskutoni, shikoni reagimin e personit. Shumica e profesionistëve do të jenë të lumtur të mësojnë diçka të re, por nëse personi reagon në një mënyrë që ju bën të ndiheni të pasigurt, mund ta diskutoni këtë me ta për t'i risiguruar ose për të kërkuar një profesionist tjetër. Gjithashtu, dëgjoni me vëmendje ndjesitë e fëmijës suaj për të gjithë profesionistët me të cilët kontaktoni. Fëmijët zakonisht, që në moshë shumë të re, janë në gjendje të shprehin një mendim nëse duan të takojnë dikë ose jo.

Nëse fëmija juaj frekuenton një vend adhurimi, mund të dëshironi ta diskutoni atë me individët e duhur. Përsëri, kjo do të varet nga gjendja juaj personale dhe si të angazhoheni me besimin tuaj. Ju personalisht mund të dëshironi të kërkon mbështetje nga një udhëheqës brenda kongregacionit tuaj, ose fëmija juaj mund të ketë një individ të besuar që ai do ta informojë.

### 4. Disa konkluzione

Në varësi të moshës dhe pjekurisë së fëmijës suaj, duhet të synoni t'i përfshini ata në të gjitha këto biseda. Fëmijët shumë të vegjël nuk mund të jenë në fazën e pjesëmarrjes së plotë në biseda, por është mirë t'i përfshihen ata që nga fillimi për t'u dhënë atyre mundësinë e zgjedhjes se sa duan të kontribuojnë. Nëse ata nuk janë të interesuar të jenë pjesë e diskutimeve ose e gjejnë të vështirë apo të turpshme, informojini se çfarë doni të thoni dhe kontrolloni nëse ata janë të kënaqur me mënyrën se si planifikoni t'i përfaqësoni. Gjithashtu, mos e supozoni se për shkak se ata nuk duan të përfshihen në një diskutim kjo nuk do të ndryshojë me kalimin e kohës. Gjithmonë u jepni atyre mundësinë për të marrë pjesë pa bërë presion mbi ta për ta bërë këtë.

# Fjalor

## Kromozome

Një strukturë e ngjashme me vargje të acideve dhe proteinave nukleike që gjenden në bërthamën e shumicës së qelizave të gjalla, që bartin informacion gjenetik në formën e gjeneve.

## Përhapje

T'i tregosh dikujt, dicka personale për veten, si për shembull të qenit interseksual.

## ÇZHS (Crregullime të Zhvillimit Seksual (ose Ndryshime të Zhvillimit Seksual)


Termi ÇZHS (DSD) u prezantua në vitin 2006 dhe që atëherë është përdorur nga profesionistët e mjekësisë për t'iu referuar trupave interseksuale. Disa individë interseksualë i përdorin këto terma kur i referohen vetes. Një numër në rritje i individëve interseksualë e konsiderojnë terminologjinë e ÇZHS (DSD) si stigmatizuese dhe preferojnë të përdorin termin interseks.

## I dyanshëm

I përbërë nga dy pjesë ose dy elementë, binar.

## Gjini

I referohet një koncepti shoqëror, i cili i vendos pritshmëritë kulturore dhe shoqërore bazuar në seksin që ju është caktuar.





## Shprehja gjinore

I referohet manifestimit të identitetit gjinor të individëve ndaj të tjerëve, për shembull, veshja, e folura dhe sjelljet. Shprehjet gjinore të individëve mund të përputhen ose jo me identitetin/identitetet e tyre gjinor/e, ose gjininë që ata kanë në lindje.

## Identiteti gjinor

I referohet përvojës të brendshme dhe individuale të ndërë thellë të çdo personi përsa i përket gjinisë, e cila mund ose nuk mund të korrespondojë me gjininë e lindjes, duke përfshirë edhe ndjesinë personale të trupit (që mund të përfshijë, nëse zgjidhet lirisht, modifikimin e paraqitjes ose funksionit fizik trupor nëpërmjet ndërhyrjeve kirurgjikale, mjekësisë ose mjete të tjera) dhe shprehje të tjera të gjinisë, përfshirë veshjen, fjalën dhe sjelljet.

Identiteti gjinor i disa njerëzve bie jashtë binarit gjinor dhe normave të lidhura

## Gjenitalet

Organet seksuale të një personi

## Gjëndrat gonadore

Testikujt, vezoret, ose testikuj-vezoret

## Hermafrodit

Term i vjetëruar, i cili përdorej shpesh për të përshkruar individët interseksualë. Në ditët e sotme, përgjithësisht konsiderohet si term përçmues.

## Interseks

Term që lidhet me një varg tiparësh ose ndryshimesh fizike që qëndrojnë ndërmjet idealeve stereotipike të meshkujve dhe femrave. Njerëzit interseksualë lindin me karakteristika fizike, hormonale ose gjenetike të cilat nuk janë plotësisht as femërore, as mashkullore; ose një kombinim i femrave dhe meshkujve; ose as femra as meshkuj. Ekzistojnë shumë forma të interseksualitetit; është një term spektër apo ombrellë, dhe jo i një kategorie të vetme.

Kjo është arsyeja përse aktivistët interseksualë shpesh preferojnë të përdorin termat karakteristikat e seksit (për shembull, kur flasim për bazat që mund të mbrohen nga diskriminimi). Nuk ekziston një gjendje statike e quajtur "statusi i interseksit", kështu që përdorimi i termit "karakteristikat seksuale" pasqyron faktin se të qenit interseks është një përvojë trupore dhe vetëm një pjesë e identitetit të një personi.

## LGBTQI

Shkurtim për Lezbike (Lesbian), Homoseksual (Gay), Biseksual (Bisexual), Transgjinnor (Transgender), Atipik (Queer) dhe Interseksual (Intersex).

### Jo binare

Term i përdorur për të përshkruar individët, identiteti gjinor i të cilëve nuk përfshihet ose është ndërmjet kategorive tradicionale të meshkujve dhe femrave.

### Seksi

Kombinimi i karakteristikave trupore të një personi, duke përfshirë: kromozomet, hormonet, organet riprodhuese të brendshme dhe të jashtme, dhe karakteristikat sekondare seksuale. Në shumicën e vendeve kjo është ende e kufizuar në binarin e femrave dhe meshkujve, të cilat mund të përjashtojnë njerëzit interseksualë.

### Karakteristikat e gjinisë/Variacionet e karakteristikave të seksit

Karakteristikat e gjinisë është një term që i referohet karakteristikave primare seksuale të një personi si: kromozomet, anatomisë, strukturës hormonale dhe organeve riprodhuese ose karakteristikave dytësore seksuale të një personi që shfaqet në pubertet si: gjinjtë, qimet e fytyrës dhe pubisit, molla e Adamit, masa muskulore, shtati dhe shpërndarja e yndyrave.

Prandaj, termi 'variacionet e karakteristikave të seksit' shihet nga shumë aktivistë si një term më i saktë sesa 'statusi i interseksit', pasi i referohet një spektri të karakteristikave të mundshme në vend të një statusi të vetëm homogjen ose përvojës për të qenë interseksual.

## Orientimi seksual

I referohet aftësisë së çdo personi për dashuri të thellë, tërheqje emocionale dhe seksuale, dhe marrëdhënie intime dhe seksuale me individë të një gjinie të ndryshme ose të gjinisë së njëjtë ose më shumë se një gjini.

## Trans

Është një term gjithëpërfshirës ombrellë që i referohet njerëzve të cilëve identiteti gjinor dhe/ose shprehja gjinore ndryshojnë nga gjinia/seksi që ata kanë në lindje.

Kjo mund të përfshijë, por nuk kufizohet vetëm në: njerëzit që identifikohen si transeksuale, transgjinore, transvestite/veshjet jo për gjininë që kanë, androgjenë, poligjinorë, gjini të papërcaktuar, agjinorë, variacione gjinore, mospërputhje gjinore, ose me ndonjë identitet/shprehje tjetër gjinore që nuk i përmbush pritshmëritë shoqërore dhe kulturore të lidhura me identitetin gjinor.

Njerëzit Interseksualë mund të identifikohen si trans, por nuk janë domosdoshmërisht trans vetëm sepse e refuzojnë seksin që kanë në lindje.

*Shumë prej përkufizimeve të mësipërme janë bërë të disponueshme nga fjalori online i ILGA Europe.*



# Adresa të dobishme

## **Organizata Europiane Interseks**

OII Europe

[www.oii europe.org](http://www.oii europe.org)

[www.intervisibility.eu](http://www.intervisibility.eu)

Young & Intersex

[www.facebook.com/Youngandintersex](https://www.facebook.com/Youngandintersex)

## **European LGBTQI Organisations**

IGLYO

[www.iglyo.com](http://www.iglyo.com)

ILGA Europe

[www.ilga-europe.org](http://www.ilga-europe.org)

Transgender Europe (TGEU)

[www.tgeu.org](http://www.tgeu.org)

## **European Parents' Organisations**

EPA

[www.euparents.eu](http://www.euparents.eu)

European Association for Children in Hospital

[www.each-for-sick-children.org](http://www.each-for-sick-children.org)

## **Burime dhe Artikuj**

Standing Up for the Human Rights of Intersex People

[www.goo.gl/NQmPSa](http://www.goo.gl/NQmPSa)

[www.goo.gl/fS3pXU](http://www.goo.gl/fS3pXU)

Promoting the human rights of an eliminating discrimination against intersex people, resolution of the Parliamentary assembly of the Council of Europe

[www.goo.gl/wZHFgW](http://www.goo.gl/wZHFgW)

Council of Europe report: Promoting the human rights of and eliminating discrimination against intersex people

[www.goo.gl/eHjPsx](http://www.goo.gl/eHjPsx)

Council of Europe Paper: Human Rights and Intersex People

[www.goo.gl/gc6QdN](http://www.goo.gl/gc6QdN)

Council of Europe: Resolution on Children's Rights to Physical Integrity

[www.goo.gl/XDjjxs](http://www.goo.gl/XDjjxs)

United Nations Convention on the Rights of the Child

[www.goo.gl/SAAouz](http://www.goo.gl/SAAouz)

Universal Declaration of Human Rights

[www.goo.gl/zwnieT](http://www.goo.gl/zwnieT)

EACH Charter

[www.goo.gl/QJ4SGe](http://www.goo.gl/QJ4SGe)

# Më tepër rreth organizatave

## **IGLYO**

[www.iglyo.com](http://www.iglyo.com)

IGLYO - Lezbike, Gay, Biseksuale, Transgjimore, Queer & Interseks Ndërkombëtare (LGBTQI) Organizata Rinore dhe Studentore është rrjeti më i madh LGBTQI për të rinjtë dhe studentët në botë me mbi 90 organizata anëtare në 40 vende të Evropës.

Objektivat e IGLYO janë:

- ndëtojnë aktivistë të rinj
- rritja e dukshmërisë dhe evidentimi i diversitetit të identiteteve rinore LGBTQI
- ta bëjnë arsimin të sigurt dhe gjithëpërfshirës për të gjithë
- të zhvillojë dhe të mbështesë një rrjet të angazhuar dhe të lidhur për organizatat anëtare

IGLYO i arrin këto objektivat përmes një programi të gjerë të trajnimeve dhe ngjarjeve ndërkombëtare, ngritjes së kapaciteteve në internet, përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së të rinjve, tregimit dixhital dhe fushatës, si dhe projektit të arsimit gjithëpërfshirës LGBTQI.

IGLYO aisbl është regjistruar si një organizatë joqeveritare në Belgjikë

(Nr. i organizatës: 808808665).

## **OII Europe**

[www.oii europe.org](http://www.oii europe.org)

OII Europe (Organisation Intersex International Europe) is the umbrella organisation of European human rights based intersex organisations with member organisations in all Council of Europe regions. OII Europe was founded on Human Rights Day, 10 December, during the Second Intersex Forum at Stockholm in 2012.

OII Europe is an autonomous affiliate of OII (Organisation Internationale des Intersexués), a decentralised global network of intersex organisations, which was founded in 2003 and has operated since then through its national groups in every region of the world.

Qëllimet e OII Europë janë:

- Zbatimi i plotë i të drejtave të njeriut, integritetit trupor dhe vetëvendosjes për njerëzit intersex

- ndalimi ligjor i trajtimit mjekësor dhe psikologjik jo konsensual; mjekët ose profesionistët e tjerë nuk duhet të kryejnë ndonjë trajtim me qëllim modifikimin e karakteristikave të seksit të cilat mund të shtyhen derisa personi që trajtohet të mund të japë pëlqimin e informuar
- promovimi i vetëdijesimit, shikimit dhe njohjes së njerëzve interseks
- Mbrojtja e plotë kundër diskriminimit dhe miratimi i termit 'karakteristikave të seksit' si një terren mbrojtës
- Edukimi i shoqërisë mbi çështjet e interseksit nga perspektiva e të drejtave të njeriut

## **EPA**

[www.euparents.eu](http://www.euparents.eu)

EPA mbledh shoqatat e prindërve në Evropë të cilat së bashku përbëjnë më shumë se 150 milion prindër. EPA punon në partneritet si për të përfaqësuar dhe për t'i dhënë prindërve një zë të fuqishëm në zhvillimin e politikave dhe vendimeve të arsimit në nivel evropian. Në fushën e arsimit, EPA synon të promovojë pjesëmarrjen aktive të prindërve dhe njohjen e vendit të tyre primar si përgjegjës për edukimin e fëmijëve të tyre.

- EPA mbështet pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin e prindërve në shumë aspekte si:
- Mbledhja dhe shpërndarja e informacionit nëpërmjet publikimeve të EPA duke përfshirë gazetatat, raportet e seminareve, faqen e internetit të EPA-s, forumet e diskutimit.
- Theksimi i inovacionit në partneritetin edukativ dhe shpërndarja e informacionit rreth praktikave edukative interesante dhe inovative.
- Promovimi i mbështetjes dhe trajnimit të vazhdueshëm të prindërve.
- Përkrahja e kërkimit në të gjitha fushat që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen e prindërve në mjedisin arsimor.
- Bashkëpunimi me partnerë të ndryshëm në fushën e gjerë të arsimit.

**TLAS**

**[www.tlas.org.al](http://www.tlas.org.al)**

TLAS (Shërbimi Ligjor Falas Tiranë) është një nga organizatat e pakta në Shqipëri që po luan rol aktiv në trajtimin, mbështetjen dhe ofrimin e shërbimeve ligjore falas për personat interseks dhe familjet e tyre.

Misioni i TLAS është përmbushja e nevojave ligjore dhe sociale e të varfërve, edukimi dhe sensibilizimi i shoqërisë shqiptare mbi sundimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut, ndërmarrja e nismave për përmirësimin e sistemit ligjor, zhvillimin e komunitetit dhe forcimin e demokracisë në Shqipëri. Objektivat e TLAS janë:

- Ofrimi i shërbimeve ligjore për njerëzit dhe grupet në nevojë;
- Ndërgjegjësimi i shtresave në nevojë dhe publikimi i informacioneve për çështje të rëndësishme ligjore dhe të të drejtave të njeriut;
- Ndërmarrja e nismave për përmirësime të legjislacionit, për rritjen e aksesit në drejtësi dhe përfshirjen sociale të njerëzve në nevojë.

**Adresa e TLAS: Bulevardi "Bajram Curri", p. "Agimi", shk. 18, ap.322, Tiranë, Shqipëri.**

**Tel: +355 04 258442; Cel: 0692093731; email: [tlas@tlas.org.al](mailto:tlas@tlas.org.al).**



Kingdom of  
the Netherlands

*Botimi dhe përshtatja e materialit në shqip është mbështetur financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulta në Shqipëri*





## Funded by



Kingdom of  
the Netherlands



This guide has been produced with the financial support of the Dutch Ministry of Education Culture & Science and the Rights Equality and Citizenship (REC) programme 2014-2020 of the European Union. The contents of this publication are the responsibility of IGLYO, OII Europe & EPA and can in no way be taken to reflect the views of the Dutch Ministry or the European Commission.